

LIGJ
Nr.9788, datë 19.7.2007

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.8875, DATË 4.4.2002 “PËR ROJËN BREGDETARE SHQIPTARE”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8875, datë 4.4.2002 “Për Rojën Bregdetare Shqiptare”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Neni 3 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 3

Varësia e Rojës Bregdetare

1. Roja Bregdetare varet nga Ministria e Mbrojtjes. Për drejtimin e operacioneve të Rojës Bregdetare Shqiptare krijohet Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD).

Në situata operacionale luftarake në kohë paqeje apo lufte, drejtimi e komandimi i Rojës Bregdetare Shqiptare bëhet nga autoritetet ushtarake.

2. Roja Bregdetare bashkëvepron me institucione dhe subjekte shtetërore ose private, që kanë interesa në det.

3. Mënyra e bashkëveprimit të Rojës Bregdetare me institucionet shtetërore, që kanë interesa në det, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Plani i zhvillimit të kapaciteteve të Rojës Bregdetare Shqiptare miratohet nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes. Plani hartohet në bashkëpunim me institucionet e përfshira në nenin 32 të ligjit nr.9251, datë 8.7.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”.

Neni 2

Pas nenit 4 shtohet neni 4/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 4/1

Drejtimi operacional i Rojës Bregdetare

1. Drejtimi operacional i Rojës Bregdetare, përveç rasteve të parashikuara në paragrafin e dytë të nenit 3 të këtij ligji, kryhet nga QNOD-ja.

2. QNOD-ja ka detyrë organizimin, planizimin dhe drejtimin e të gjitha operacioneve detare, për kontrollin e zbatimit të legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar në det, kërkimin, shpëtimin dhe dhënien e ndihmës në hapësirën detare, duke përdorur, në mënyrë të integruar, të gjitha kapacitetet operacionale të disponueshme nga institucionet e përcaktuara në nenin 32 të ligjit nr.9251, datë 8.7.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”.

3. Struktura, mënyra e organizimit dhe e funksionimit të QNOD-së përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Struktura e QNOD-së ka në përbërje personel nga të gjitha institucionet e përcaktuara në nenin 32 të ligjit nr.9251, datë 8.7.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”.

Neni 3

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda tre muajve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5443, datë 31.7.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**